

Teuta SHALA

RAMË BINAKU FIGURË E NDRITUR E LËVIZJES ÇLIRIMTARE

Lëvizja e armatosur si formë e qëndresës së popullit shqiptar ka luajtur rol me rëndësi në luftë kundër pushtuesve osmanë dhe serbo-malazezë për çlirim e bashkim kombëtar. Ajo vepronte në çeta të cilat zhvillonin aksione të armatosura kundër ushtrisë osmane dhe forcave të xhandarmërisë e të ushtrisë së Mbretërisë Jugosllave. Një rol të rëndësishëm në Lëvizjen e armatosur e luajti edhe çeta e Hazir Sylës, e formuar më 1903,¹ që veproi në rajonin e Dushkajës. Luftëtarët e kësaj çete treguan guxim dhe trimëri të rrallë. Në mesin e tyre u dallua edhe Ramë Binaku i fshatit Dashinoc.

Fëmijëria e Ramë Binakut

Ramë Binaku u lind në vitin 1887 në fshatin Dashinoc të Deçanit,² në një familje të njohur për trimëri e bujari. Që në fëmijëri ai u edukua me

1. Bajram Mehmetaj, Dyzet vjet me çetat kaçake, 1994, f. 24.

2. Deklaratë e Rexhep Berishës nga fshati Dashinoc, i biri i Ramë Binakut, shënuar më 4. 6. 2004.

dashuri për atdheun, edukatë të cilën e trashëgoi nga prindërit e tij, babai Binak Hajdari dhe nëna Baftë. Binak Hajdari ishte i njohur në këto anë për trimëri e bujari, ndërsa nëna Baftja rridhte nga një familje e njohur me tradita patriotike afër Tutinit.

Ramë Binaku që në fëmijëri u përballua më vështirësi. Në moshën 4-vjeçare pushteti osman ia arreston babain, i cili pas një kohe do të vdesë në njërin nga burgjet e Perandorisë Osmane,³ përkrahja e pamjaftueshme dhe kushtet e vështira ekonomike e shtynë nënën e Ramës që së bashku me fëmijët të qëndrojnë për një kohë te familja e saj në Tutin. Pas afro tri vjet qëndrimi te dajët e tij Rama së bashku me familje kthehet sërish në vendlindjen e tij në Dashinoc. Pas kthimit kjo familje hasi në vështirësi të shumta, por falë përkrahjes që i ofruan disa familje, si ajo e Sokol Hajdarit, Ramë Hasan Dodës dhe e Dervish Selmanit, iu dha mundësia që t'i kthehet jetës normale.⁴

Inkuadrimi në çetat kaçake dhe veprimtaria e tij

Në moshën 16-vjeçare Ramë Binaku së bashku më vëllain, Hajdarin (i cili vritet në luftë në Sukë të Babajt) iu bashkuan çetës së Hazir Sylës⁵, ku iu dha mundësia të bashkëveprojë me shumë burra trima nga viset e tjera të Kosovës, si me Zymer Fazlinë, Bajram Daklanin, Zhujë Haxhinë etj. Ai ishte në kontakt me personalitetet më të dalluara të Lëvizjes Çlirimtare, si me Bajram Currin, Azem Bejtën, Shotë Galicën

3. Po aty.

4. Po aty.

5. Po aty.

etj. Bashkë me çetën Ramë Binaku mori pjesë në një sërë aksionesh të suksesshme kundër pushtuesve osmanë, si në Sukë të Babajt, në Beleg të Deçanit etj. Luftëtarët e kësaj çete morën pjesë në betejën e qafës së Prushit të udhëhequr nga Bajram Curri, në qershor të vitit 1909.⁶

Pas këtyre aksioneve çeta e Hazirë Sylës u nda në disa grupe. Nga njëri grup u formua më vonë çeta e njohur e Ramë Binakut, e cila ndërmori shumë aksione në rrethinat e Pejës e të Gjakovës.⁷ Çeta e tij nuk ishte shumë e madhe, por në të bënin pjesë luftëtarët më të njohur, si Zymer Fazlia, Bajram Syla,⁸ Isuf Musa, Zhujë Avdyli, Selim Rama, Adem Rama etj.⁹ Ramë Binaku me disa bashkëluftëtarë mori pjesë edhe në Shpalljen e Pavarësisë së Shqipërisë më 28.11.1912 në Vlorë.

Vlen të theksohet se në mesin e 300 luftëtarëve më të dalluar kosovarë që morën pjesë në luftën për mbrojtjen e Durrësit më 1914 u shqua edhe Ramë Binaku.¹⁰

Pas fillimit të Luftës së Parë Botërore treva e Deçanit, sikurse edhe një pjesë tjetër e Kosovës, u pushtua nga Austro-Hungaria. Gjatë kësaj kohe Ramë Binaku u arrestua në burgun e Pejës nën akuzën se kishte vrarë një major austro-hungarez dhe u dënua me vdekje, por u arratis nga burgu.¹¹

Pas thyerjes së ushtrisë austro-hungareze, në vjeshtë të vitit 1918, në Kosovë u rivendos pushteti

6. Bajram Mehmetaj, vep. e cit. f. 27.

7. Po aty, f. 29.

8. Nga deklarata e Rexhep Berishës...

9. Bajram Mehmetaj, vep. e cit. f. 29.

10. Shih gjerësisht : B. Mehmetaj, vep e cit, f. 61.

11. Nga deklarata e Rexhep Berishës...

serb.¹² Pushtuesi serb ndërmori masa të ashpra ndaj popullit shqiptar në viset e pushtuara. Lëvizja Çlirimtare për Bashkim Kombëtar, e udhëhequr nga Komiteti i Kosovës e vazhdoi qëndresën e armatosur edhe në këto anë. Në këto aksione u shquan prijësit e çetave të lirisë si Ramë Binaku, Isuf Musa, Mehmet Uka etj.¹³

Gjatë muajve korrik-gusht të vitit 1921 Lëvizja Çlirimtare në Rrafshin e Dukagjinit, e veçanërisht në brezin kufitar me Shqipërinë, ishte mjaft aktive. Çeta e Ramë Binakut, Rexhë Alisë, Hasan Sejdës, Isuf Musës, Haxhë Sadrisë etj. sulmoi kazermën e ushtrisë serbe në Gjakovë dhe ndërmori aksione të armatosura kundër patrullave të xhandarmërisë. Këto aksione patën jehonë të madhe te popullsia e kësaj ane.¹⁴

Nga fundi i vitit 1921 u formua „Zona Neutrale e Junikut“, e cila shërbeu si vendstrehim i luftëtarëve të lirisë nga të gjitha viset e Kosovës, prej nga ndërmerreshin aksione kundër pushtuesit serb. Në këtë zonë rol të rëndësishëm luajti edhe Ramë Binaku me çetën e tij.

Pas shuarjes së Zonës Neutrale të Junikut Ramë Binaku me çetën e tij kaloi në Malësi të Gjakovës. Atje çeta organizoi një sërë aksionesh të rëndësishme kundër forcave të xhandarmërisë dhe ushtrisë së Ahmet Zogut. Veçohet sidomos kontributi i saj në Kryengritjen e Krumës (maj 1924). Bajram Curri dërgoi në rrethin e Gjakovës Ramë Binakun, Isuf Musën e Rexhë Alinë, të cilët brenda pak ditësh

12. F. Mehmetaj- F. Ramosaj, Deçani-Monografi, Deçan, 1997, f. 207.

13. Bajram Mehmetaj, vep. e cit. f. 80-81.

14. Bajram Mehmetaj, vep. e cit. f. 112-113.

organizuan shumë vullnetarë për të marrë pjesë në këtë kryengritje.¹⁵

Shuarja e Zonës Neutrale të Junikut, vrasja e Azem Bejtës, Bajram Currit dhe drejtuesve të tjerë të Lëvizjes Kombëtare Shqiptare i dha goditje të rëndë qëndresës shqiptare. Megjithatë, lëvizja e armatosur nuk u shua plotësisht. Çeta e Ramë Binakut me bashkëluftëtarë vazhdoi qëndresën deri në shpartallimin e Mbretërisë jugosllave. Pas mbarimit të Luftës së Dytë Botërore ai vazhdoi luftën e armatosur kundër pushtuesve jugosllavë deri më 1947. Gjatë kësaj kohe kishte si bashkëluftëtarë Sokol Nikën dhe Isë Nezirin, me të cilët më 1947 dorëzohet.¹⁶

Jeta e Ramë Binakut pas dorëzimit më 1947

Pas një lufte 45-vjeçare Ramë Binaku më në fund dorëzohet,¹⁷ kthehet në shtëpi me shpresë se ditët e pleqërisë do t'i kalojë të qeta pranë familjes. Por edhe pas kësaj kohe atë nuk do ta lënë të qetë. Vitet që pasuan ishin mjaft të vështira për të dhe për familjen e tij, meqë kjo familje vazhdimisht ishte në shënjestër të pushtetit të atëhershëm. Disa herë do të bastiset dhe keqtrajtohet në forma të ndryshme.¹⁸

Edhe pas dorëzimit Ramë Binaku kohë pas kohe kishte provokime të ndryshme. Një nga to ishte rasti kur më 1957 ftohet nga organet e sigurimit në polici të Deçanit për t'i dorëzuar armët.¹⁹ Provokime të

15. F. Mehmetaj- F. Ramosaj, vep. e cit. f. 288.

16. Nga deklarata e Rexhep Berishës....

17. Po aty.

18. Po aty.

19. Po aty.

ngjashme ai pati edhe disa herë mëpastaj, por edhe pse në moshë të thyer arriti të përballojë çdo provokim që iu bë nga pushteti i atëhershëm, duke i qëndruar besnik atdheut të tij gjer sa vdes më 23 mars 1961.

Ramë Binaku, me kontributin e tij në luftë për çlirimin dhe bashkimin kombëtar zuri vend në mesin e figurave më të ndritura të Lëvizjes Çlirimtare për gati një gjysmë shekulli.